


A V O K A T
Edmond HICKA
Tirane

A K T M A R V E S H J E
PER KRIJIMIN E SHOQERISE TREGTARE
"ALFA-SHERBIMET" (ALFA-SERVICES)



Sot, me dt. 28/02/1994 (nentdhjet e kater), diten e Hënë para meje Av.Edmond Hickes, me banim ne Tirane, u paraqiten personalisht: FATOS ÇUÇI i biri i Edipit dhe i Myrvetes, lindur ne Korçë me 1950 e banues ne Tirane, i njohur personalisht prej meje; LUCIA MARIA BERTINO e bija e Giacomas dhe e Maria Pires, lindur ne Ivrea te Italise me 1952 e banuese po ne Ivrea, Via Della SERRA 1, per identitetin e saj u vura ne dieni nga Pasaporta e saj, madhore e me zotesi per te vepruar, te cilet me kerkuan te redaktohet, ne pese kopje Akti i Krijimit te Shoqerise Tregtare "ALFA-SHERBIMET" (ALFA-SERVICES), me termat si me poshte:

NENI 1

Lucia Maria Bertino, e cila me poshte do te quhet Ortakja e pare dhe Fatos Çuçi, i cili me poshte do te quhet Ortaku i dyte, rane dakort e shprehen vullnetin per krijimin e Shoqerise Tregtare me pergjegjesi te kufizuar me:

EMERTIM : "ALFA-SHERBIMET" shpk, ose "ALFA-SERVICES"
KOHEZGJATJE: Deri ne vitin 2021
VENDNDODHJE: Rr.Durresit, Qendra Tregtare Tirana, Dhoma 16.
KAPITAL : 100.000(njeqindmije)leke (ekuivalenti 1.000USD)
i cili eshte i ndare ne kuota, ne menyren e pershkruar me poshte.
OBJEKT : Realizimi i projekteve teknike ne fushen e elektronikes; tregtimi i paisjeve te ndryshme elektronike; tregtim i paisjeve te ndryshme elektronike; tregtim i paisjeve e atrecaturave te ndryshme per zyra; tregtim i artikujve te konsumit e te kancelarive; prodhim e tregtim i paisjeve e artikujve te ndryshem; eksport-importi i te gjitha llojeve per realizimin e veprimtarise se me siperme si dhe kryerja e sherbimeve te ndryshme, perjashtuar atyre te ndaluara me ligj.

NENI 2

Kapitali themeltar i shoqerise eshte i nenshkrueshem e i likuidueshem. Ai krijohet nga kuotat e ortakeve si me posht:
Ortaku i pare: -50.000(pesedhjetmije) leke baraz me 50%
Ortaku i dyte: -50.000(pesedhjetmije) leke baraz me 50%
Kapitali themeltar perbehet nga te holla te depozituara.

NENI 3

Sejcili ortak, per likuidimin e kuotave qe sherbejne per krijimin e kapitalit themeltar, do te paiset me nje vertetim sipas te cilil vertetohet likuidimi i kuotes perkatese. Likuidimi i kuotave do te pasqyrohet edhe ne librin e Ortakeve.

NENI 4

Rregullat per funksionimin e Shoqerise pasqyrohen ne statutin qe



Ministria e Financave
i Bashkangjitet Aktit te Krijimit te Shoqerise.

NENI 5

Administrimi i zakonshem e i jashtzakonshem i Shoqerise, perfaqsimi ligjor i saj para te treteve, Gjykates, organeve shtetore etj. i besohet Keshillit Administrativ i cili perbehet nga:

Administrator: -Fatos Çuçiqi

Keshilltar: -

Emerimin si me siper te lartpermendurit e pranuan ne çast.

NENI 6

Numri i pjsmarjes se Ortakeve te tjere ne shoqeri nuk eshte i kufizuar, po ky vendoset nga Ortaket.

NENI 7

Ortaket kane keto te drejta.

-Administrimin e shoqerise ne perputhje me Aktmarveshjen e Krijimit, Statutin e Shoqerise qe i bashkangjitet ketij akti si dhe dispozitave ligjore ne fuqi.

-Pjesmarrjen ne rezultatet e çdo forme e sasie te veprimtarise se Shoqerise.

-Marrjen e te dhenave rreth gjendjes ekonomike e tregtare te Shoqerise si dhe mbi te gjithe dokumentacionin.

-Paraqitjen e propozimeve dhe shqyrtimin e tyre nga te gjithe Ortaket.

NENI 8

Ortaket kane keto detyrime:

-Likuidimin e kuotave respektive per krijimin e kapitalit themeltar si dhe te shumave suplementare, kur eshte e nevojshme dhe vendoset nga Ortaket.

-T'i japi Shoqerise te dhena te domosdoshme per perpunimin e çdo objektivi te veçante qe lidhet me veprimtarine e Shoqerise.

-Te kryej detyrat per realizimin e qellimeve per te cilat eshte krijuar Shoqeria.

-Te ruaj fshehtesine e Shoqerise ne te gjitha drejtimet.

NENI 9

Perfaqsimi i Shoqerise Tregtare "ALFA-SHERBIMET" shpk (ALFA-SERVICES) para te treteve, para organeve shtetore, para Bashkise se Tiranes e qyteteve te tjera te Shqiperise, para Gjykates, para Bankave etj. behet nga Administratori. Ne mungese te tij perfaqsimi si me siper do te behet nga nje person i zgjedhur prej tij e i pajisur me prokur te posaçme apo te per gjithshme, ne vartesi te problemit qe i besohet te kryej.

NENI 10

Ne se nje nga ortaket vdes, atehere trashgimtaret e tij kane te drejte te marrin pjese ne Shoqeri me cilesin e Ortakut. Kur ata nuk pranojne, e per kete duhet te njoftojn me shkrim, atehere jane te detyruar te bejne propozimet per kushtet e transferimit te kuotes pjesmarrese ne kapitalin themeltar. Rregullat e transferimit te kuotes pershkruhen ne Statut.

NENI 11

Ne se Shoqerise i lind nevoja te lere peng nje pjese te pasurise

se saj, atehere eshte e detyruar qe te vere ne dijeni pengmarresin, qe ne fillim, se pasurine do ta kthej. Ne te mbarimin e afatit te pengut, pengmarresi ka te drejt te marri pjese ne Shoqeri me cilesin e Ortakut, ne masen e pasurise se lene peng. Ne kete rast eshte e detyrueshme qe brenda nje muaji te behen ndryshimet ne Aktin e Krijimit dhe ne Statutin perkates.

NENI 12

Aktmarrveshja per krijimin e Shoqerise Tregtare "ALFA-SHERBIMET" shpk (ALFA-SERVICES), eshte e vlefshme deri ne mbarimin e afatit te parashikuar ne NENIN 1, por Ortaket kene te drejt ta perserisin Aktmarrveshjen.

NENI 13

Ne rastin kur Shoqeria do te ipotekoj pjese te pasurise se saj, atehere do te veprohet sipas ligjes perkatese qe parashikon me hollesi ipoteken, privilegjin e pengun.

NENI 14

Mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate zbatimit te kesaj Aktmarrveshjeje do te zgjidhen me marrveshje midis paleve, duke caktuar sejcili nga nje perfaquesues dhe kur kjo te mos jete e mundur, atehere sejcili ka te drejte t'i drejtohet Gjykates.

NENI 15

Personi pergjegjes per krijimin e Shoqerise eshte Ortaku i dyte.

NENI 16

Kjo Aktmarreveshje eshte e vlefshme qe nga casti i neshkrimit te saj.

NENI 17

Aktmarreveshja redaktohet ne pese kopje, me tre faqe, ne gjuhen shqip e italisht, te njevlefshme ligjerisht.

NENI 18

Aktmarreveshja pasi u lexua nga palet e u gjet e formuluar sipas vullnetit te shprehur prej tyre u nenshkrua rregullisht.

LUCIA BERTINO

Lucia Bertino

FATOS ÇUÇI

Fatos Cuci

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTESISE


N O T E R I A

Nr. 94/43 rep.
Nr. 1377 kol.

V E R T E T I M

Sot, me 4 Mars 1994 (nentdhjet e kater), diten e _____, ne zyren e Noterise, para meje _____, notere ne kete qytet, u paraqiten personalisht: LUCIA MARIA BERTINO e bija e Giacomas dhe e Mariës Piras, lindur ne Ivrea te Italise me 1952 e banuese po aty, shtetase italiane, e pa njojur prej meje, per

A V O K A T
Edmond HICKA
Tirane



S T A T U T I
PER VEPRIMTARINE EKONOMIKO-FINANCIARE TE SHOQERISE
TREGTARE "ALFA-SHERBIMET" (ALFA-SERVICES) shpk

KREU I
DISPOZITA TE PERGJITHSHME

NENI 1

Shoqeria Tregtare "ALFA-SHERBIMET" (ALFA-SERVICES) shpk, eshte prone private me ortakeri, ndermjet Fatos Çuçit dhe shtetasë italiane Lucia Bertino, me pergjegjesi te kufizuar.

NENI 2

Shoqeria "ALFA-SHERBIMET" (ALFA-SERVICES) shpk, eshte person juridik shqipetar. Ajo fiton zotesin per te vepruar nga çasti i regjistrimit si person juridik ne Gjykate.

NENI 3

Shoqeria Tregtare "ALFA-SHERBIME" (ALFA-SERVICES) shpk, zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe dispozitat e parashikuara ne Aktmarrveshjen e Krijimit e ne kete Statut.

NENI 4

Shoqeria Tregtare "ALFA-SHERBIMET" (ALFA-SERVICES) shpk krijohet per: realizimin e projekteve teknike ne fushen e elektronikes e te informatikes; tregtimin e paisjeve te ndryshme elektronike; tregtimin e paisjeve e atrecaturave te ndryshme per zyra; tregtim i artikujve te konsumit e te kancelarive; prodhim e tregtim te artikujve te ndryshem elektronik; eksport-importi i te gjitha llojeve per realizimin e veprimtarise se me siperme si dhe kryerja e sherbimeve te ndryshme, perjashtuar ato te ndaluara me ligj.

NENI 5

Shoqeria Tregtare e ka vend ndodhjen ne Tirane, Rr. Durresit, Tirana Trade Center, Dhoma 16.

Ajo ka te drejt te çele dege, perfaqsi e filiale ne qytete te tjera te Shqiperise dhe vendeve te tjera, duke patur parasysh kerkesat e ligjes si dhe legjislacionin e vendit ku ato do te çelen.

NENI 6

Trasferimi kuotes se pjesmarjes ne shoqeri do te behet duke paraqitur propozimin perkates me shkrim.

Ne rastin kur njeri nga Ortaket do te heqi dore nga Shoqeria, atehere ai eshte i detyruar t'u ofroj kuoten e vete Ortakeve te tjere. Per kete ai eshte i detyruar te paraqes propozimin me shkrim, ku parashtrohen kushtet e ndryshme. Ortaket jane te detyruar te perggjigjen brenda 30 diteve, ne te kundert Ortakut qe kerkon te heqe dore i lind e drejta t'ja shese kuoten e vete te treteve, por me te njejta kushte qe ia ka propozuar Ortakeve.

me te njejtene menyre do te veprohet edhe nga trashgimtaret e
Ortakut te vdekur, kur ata nuk pranojne te marrin pjesë ne
Shoqeri me cilesine e Ortakeve.

NENI 7

Heqja dore nga Shoqeria nuk e shkarkon Ortakun nga detyrimet ndaj
Shoquerise dhe nuk pengojne detyrimet e Shoquerise ndaj Ortakut.

NENI 8

Ortaket per gjigjen per detyrimet e Shoquerise deri ne kufijt e
kuotes pjesemarrese ne kapitalin themeltar.

NENI 9

Shoqeria Tregtare "ALFA-SHERBIMET" (ALFA-SERVICES) shpk,
per gjigjet ndaj te treteve me fondet e veta.

KREU II

MARREDHENIET EKONOMIKO-FINANCIARE

NENI 10

Veprimtaria e Shoquerise realizohet ne mbeshtetje te leverdise
ekonomike dhe pasqyrohet ne bilancin e saj.

NENI 11

Per te bere te mundur zhvillimin e veprimtarise se saj, Shoqeria
Tregtare "ALFA-SHERBIMET" (ALFA-SERVICES) shpk, ka nje kapital
themeltar prej 100.000(njegindmije)leke, qe perbehet nga
kartmonedha dhe pasuri te paluajteshme, pasqyruar ne proces
verbalin e inventarit, bashkangjitur ketij akti. Ky kapital
themeltar perben burimin fillestar per krijimin e fondit rezevre,
te fondit te vecant e te mjeteve te xhiros.

NENI 12*

Kur Shoqeria Tregtare "ALFA-SHERBIMET" (ALFA-SERVICES) shpk,
pushon veprimtarine e saj, atehere me pare eshte e detyruar te
shlyej detyrimet ndaj te treteve. Pjesa e mbetur e pasurise
ndahet midis Ortakeve sipas perqindjes se pjesmarjes ne kapitalin
themeltar.

NENI 13

Shoqeria ka te drejten e tjetersimit, gezimit e te perdorimit te
pasurive te saj, ne perputhje me qellimet e objektet e
veprimtarise per te cilin eshte krijuar.

NENI 14

Shoqeria Tregtare "ALFA-SHERBIMET" (ALFA-SERVICES) shpk, gezon
te drejten e mbrojtjes se pasurive te saj ne perputhje me
legjislacionin ne fuqi.

NENI 15

Shoqeria Tregtare "ALFA-SHERBIMET" (ALFA-SERVICES) shpk, me
fondet rezerve dhe fondet e tjera te vecanta ka te drejte te
kryej lirisht çdo lloj veprimtarie ekonomike, tregtare,
financiare, me persona juridik e fizik, shqiptar apo te huaj,
shtetror ose privat.

Parberja shuma e pergjithshme, burimet per krijim e tyre, perdorimi e rregullimi i tyre vendoset nga Asamblea e Ortakeve.

Detyrimet qe lindin gjate ushtrimit te veprimtarise, ose nga marrheniet me te tretet, mbulohen me fondet e vete Shoqerise, ose nga shumat suplementare qe mund te likuidohen me kapitalin themeltar kur detyrimet nuk mbulohen me fondet ekzistuese.

NENI 16

Shoqeria, sipas mundesive qe do t'i krijohen, ka te drejte te investoj ne ndermarrje apo institucion te tjera, qofshin keto shtetore apo private ose te disponoj aksione ne ndermarje te tjera, sipas dispozitave ne fuqi.

NENI 17

Pasurite e Shoqerise pasqyrohen ne bilancin e saj, te shprehura ne Leke ose ne valute te huaj te konvertueshme.

Bilanci i veprimtarise i çdo viti paraqitet brenda muajit Mars te vitit pas ardhesh.

Forma e bilancit dhe e llogarive do te jete ajo qe parashikohet nga ligja, me dispozita te vecanta.

NENI 18

Bilanci dhe llogarite e Shoqerise mbahen ne vendndodhjen e Shoqerise, ne Shqiperi.

NENI 19

Veprimtaria financiare e Shoqerise mbeshtetet ne aktivin dhe pasivin e pasqyruar ne bilanc.

Rezultatet financiare te Shoqerise caktohen ne mbeshtetje te bilancit vjetor.

NENI 20.

E ardhura neto e Shoqerise, pasi zbriten te gjitha shpenzimet e aktivitetit duke perfshire amortizimin, pagat, shpenzimet per blerjen e materialeve, energjia, etj. te nevojshme per veprimtarine e Shoqerise, pa prekur fondin rezevre ndahet midis Ortakeve proporcionalisht me kuoten e pjesmarrjes ne kapitalin e Shoqerise.

Ortaket e huaj, mund te transferojne te ardhurat e tyre lirisht jasht shtetit ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

NENI 21

Marredheniet e punes me puntoret qe do te punesohej prane Shoqerise rregullohen me kontrata individuale, te cilat do te lidhen me sejcilin prej tyre.

NENI 22

Paga per punen e kryer caktohet nga Asambleja e Ortakeve, ne perputhje me treguesit ekonomiko-financiar. Ne mbeshtetje te kushteve konkrete paga per punen e kryer mund te jepet orare, ditore, javore dhe mujore. Madhesia e shperblimit per punen e

kryer nuk kufizohet, por nuk mund te jete me e vogel nga sa parashikohet me dispozita te vecanta.

KREU III
ORGANIZIMI DHE DREJTIMI ADMINISTRATIV

NENI 23

Organ vendimor i Shoqerise eshte Asamblea e Ortakeve e cila ka te drejte te vendose: per bilancin vjetor, per ndryshimet ne Aktin e Krijimit dhe ne kete Statut, per shtimin ose paksimin e kapitalit themeltar, per shlyerjen e shumave suplementare ne kapitalin themeltar, per emrimin e Administratorit, per pushimin veprimtarise se Shoqerise, per riorganizimin e saj si dhe per drejtimet kryesore te veprimtarise se Shoqerise.

Asamblea e Ortakeve vendos me shumice absolute votash ne rastet si me poshte:

- Per ndryshimet ne Statut
- Per rritjen ose zvoglimin e kapitalit themeltar
- Per zgjatjen e afatit te ekzistences se Shoqerise
- Per pushimin dhe riorganizimin e Shoqerise

Per problemet e tjera Asamblea e Ortakeve vendos me shumice te thjeshte votash.

NENI 24

Asamblea e Ortakeve mblidhet te pakten nje here ne vit. Ajo mund te shtye mbledhjen e saj jo me shume se dy muaj, mbas miratimit te bilancit vjetor.

Vendimet e marra nga Asamblea e Ortakeve jane te detyrueshme per tu zbatuar nga te gjith Ortaket, edhe pse ndonjeri mund te kete votuar kunder.

NENI 25

Asambleja e Ortakeve ne mbledhjen e saj te zakonshme e te jashtzakonshme thiret nga Administratori, me leter te rekomanduar.

Per daten, oren dhe vendin, i cili mund te jete edhe jashte vendndodhjes se Shoqerise, njofnjoftimi behet 30 dite para. Ne njoftim behet i ditur edhe rendi i dites i mbledhjes.

Per mbledhjet e jashtzakonshme, te cilat mund te organizohen per likuidimin e shumave suplementare ne kapitalin themeltar, per pushimin e veprimtarise se Shoqerise, per emrimin e Administratorit, per ndryshimet ne Aktin e Krijimit e ne Statut, organizimi i tyre behet sa te jete e mundur me shpejte, pa ndonje percaktim ne kohe.

NENI 26

Sejcili Ortak ka te drejte te marre pjesa ne mbledhjen e Asamblese, kur eshte regjistruar ne librin e Ortakeve te pakten 5 dite me pare.

Kur ndonjeri prej Ortakeve, per arsyte te perligjura nuk ka mundesi te marri pjese ne Asamblene e Ortakeve personalishte, atehere mund te dergoj perfaqsuesin e tij, me kusht te mos jete punonjes i administrates dhe ta kete paisur me prokur te posaçme.

Ne kete rast, Administratori, para fillimit te mbledhjes, eshte i detyruar te verifikoj aktin e delegimit.

NENI 27

Mbledhja e Asamblese kryesohet nga Administratori. Kur ai mungon, Ortaket mund te zgjedhin nje person tjeter, me kusht te mos jete punonjes i administartes.

Per zhvillimin e mbledhjes Asamblea cakton edhe nje sekretar, po ashtu jo punonjes te administrates.

Ne mbledhjen e Asamblese mund te jete i pranishem edhe nje avokat, te cilit ne perfundim i besohet redaktimi i vendimeve dhe legalizimi i procesverbalit te mbledhjes.

NENI 28

Drejtimi administrativ i Shoqerise i besohet Keshillit Administrativ, numri perberes i te cilit caktohet nga Asamblea e Ortakeve.

Keshilli Administrativ drejtohet nga Administratori i Shoqerise.

Emerimi i Administratorit, i cili mund te jete ose jo Ortak, behet ne mbledhjen e pare te Asamblese se Ortakeve.

NENI 29

Keshilli Administrativ realizon drejtimin administrativ te Shoqerise. Kompetencat e Keshillit Administrativ percaktohen nga Asambleja e Ortakeve, qe ne çastin e emrimit te tij.

Keshilli Administrativ perpilon te gjitha dokumentet e kryen te gjitha punet qe i sherbejne realizimit te veprimitarise se Shoqerise.

NENI 30

Mbledhjet e Keshillit Administrativ organizohen nga Administratori, per çdo problem, ne çdo kohe.

Ne mungese te Administratorit mbledhjet e Keshillit Administrativ kryesohen nga nje person i caktuar prej tij.

Vendimet e marra ne mbledhjen e Keshillit Administrativ jane te detyrueshme per t'u zbatuar nga te gjithe punonjesit.

Keshilli Administrativ i merr vendimet me shumice te thjeshte votash e kur ato barazohen, atehere pranohet varianti per te cilin ka votuar Administratori.

NENI 31

Perfaqesimi dhe e drejta e firmes i perket Administratorit. Kur

mungon, me prokur te posaçme, mund te caktohet nje person tjetër, i zgjedhur prej tij.

Per veprimet bankare, nenshkrimin e çeçeve e te dokumentacioneve te tjera bankare, nenshkrimin e ka te drejt vetem Administratori.

NENI 32

Asambleja e Ortakeve mund te zevendesoj Keshillin Administrativ me nje Administrator te vetem, i cili ka te gjitha kompetencat si edhe Keshilli Administrativ.

NENI 33

Per te kontrolluar veprimtarine financiare te Shoqerise, Ortaket caktojne nje ose me shume ekspert kontabel. Kur ata nuk bien dakord per nje gje te tille, atehere i drejtohen Gjykates e cila emron ekspertin si dhe percakton masen e shperblimit te tij per punen qe do te kryej.

Ekspertet kontabel perpilojne aktin e kontrollit e ia paragesin ate per shqyrtim e miratim Asamblese se Ortakeve.

Ne te njejtën menyre veprohet edhe per bilancin vjetor.

NENI 34

Anetareve te Keshillit Administrativ dhe punonjesve te tjere te Shoqerise u paguhen shpenzimet qe ata bejne per nevoja zyrtare te Shoqerise, por me kushte qe te vertetohen me dokumenta.

**KREU IV
RIORGANIZIMI DHE PUSHIMI I VEPRIMTARISE**

NENI 35

Veprimtaria e Shqiperise mbaron me mbarimin e afatit te percaktuar ne Aktmarrveshjen e krijimit si edhe me propozimin e shumices se Ortakeve kur ajo nuk rezulton me fitim.

Asambleja e Ortakeve cakton ekspertet kontabel te cilet pergatisin aktin e likuidimit, i cili merret ne shqyrtim prej saj. Ne vendimin per pushimin e veprimtarise percaktohen: shlyerja e detyriimeve ndaj te treteve, ndarja e pasurive qe i mbeten Shoqerise sipas perqindjes se pjesmarjes si dhe data e pushimit te veprimtarise.

NENI 36

Ne rast se Shoqeria duhet te riorganizohet, atehere do te veprohet sipas percaktimit qe behet ne Ligjen per Shoqerite Tregtare.

NENI 37

Pushimi i veprimtarise se nje perfaçesie, dege apo filiali do te behet njesoj siç veprohet per pushimin e veprimtarise se Shoqerise. Ne keto raste pasurite e mbetura i kalojne Shoqerise.

NENI 38

Konfliktet qe mund te lindin nga zbatimi i Aktit te Krijimit dhe nga ky Statut, do te zgjidhen me marrveshje, duke caktuar secila pale nga nje perfaqesues. Ne se konflikti nuk do te zgjidhet me mirekuptim, atehere sejcila pale ka te drejte t'i drejtohet Gjykates.

NENI 39

Ky Statut eshte perpiluar ne pese kopie, me shtate faqe, ne gjuhen shqip e italisht, te njevlefshme ligjerisht dhe eshte i vlefshem qe nga casti i nenshkrimit te tij. Ai mund te ndryshohet ne çdo cast ne perputhje me kerkesat e ketij Statuti.

Akti si me siper pasi u lexua nga palet u gjet i formuluar sipas vullnetit te shprehur prej tyre dhe u nenshkrua rregullisht, me vullnet te lire e te pa varur.

LUCIA BERTINO

FATOS ÇUÇI

Fatos Çuci

Xhane Bertino


REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTESISE

N O T E R I A

Nr. 44143 rep.
Nr. 13750 kol.

V E R T E T I M

Sot, me 7 Mars 1994(nentdhjet e kater), diten e _____, ne zyren e Noterise, para meje _____, notare ne kete qytet, u paraqiten personalisht: LUCIA MARIA BERTINO e bija e Giacomas dhe e Maries Piras, lindur ne Ivrea te Italise me 1952 e banuese po aty, shtetase italiane, e pa njojur prej meje, per identitetin e te ciles morra dijeni nga Pasaporta e saj, madhore; FATOS ÇUÇI i biri i Edipit e i Myrvetes, lindur ne Korçë me 1950 e banues ne Tirane, per identitetin e te cilit u vura ne dijeni nga leternjftimi i tij, madhor; te cilet me deklaruan se jashte kesaj Zyre kane redaktuar Statutin per Veprimtarine Ekonomiko-Financiare te Shoqerise Tregtare "ALFA-SHERBIMET" shpk (ALFA-SERVICES), me termat si me siper, permbajtjen e te ciles ua lexova e pasi e gjeten te formuluar sipas vullnetit te shprehur prej tyre e nenshkruan rregullisht para meje, çka vertetohet me nenshkrimin tim.



NOTERE
SIPAS
MOZA SINDUSHO
TIRANA

Omer